RAPORT MONITORIMI MBI REALIZIMIN DHE ZBATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT

SEKRETARIATI KOMBËTAR I NISMËS PËR TRANSPARENCË NË INDUSTRINË NXJERRËSE (EITI SHQIPËRI)

VITI 2024

TABELA E PËRMBAJTJES

Lista e shkurtesave.....3

Hyrje.....4

1. Monitorimi i Planit të Integritetit për vitin 2024.....5

   1.1 Qasja vlerësuese.....5
   1.2 Metodologjia e vlerësimit.....5
   1.3 Mbledhja e të dhënave.....5
   1.4 Monitorimi i zbatimit të planit të veprimit.....6

2. Konkluzione dhe rekomandime.....8

LISTA E SHKURTESAVE

ASPA – Shkolla Shqiptare e Administratës Publike

EITI – Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse

MVRI – Metodologjia e Vlerësimit të Riskut të Integritetit

PI – Plani i Integritetit

PT – Programi i Transparencës

SNKK – Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit

Hyrje

Në kuadër të SNKK, garantimi i integritetit në sektorin publik konsiston në përmbushjen e detyrimeve të transparencës, llogaridhënies, etikës, ndershmërisë, efektivitetit dhe eficencës në kryerjen e detyrave dhe ushtrimit të funksioneve rregullatore dhe administrative.

Lufta kundër korrupsionit dhe sigurimi i integritetit të punonjësve për Sekretariatin Kombëtar EITI Shqipëri ka qënë dhe mbetet shumë e rëndësishme me qëllim arritjen e rezultateve të larta në forcimin e integritetit institucional, mirëqeverisjen, si dhe transparencën për publikun.

Hartimi dhe miratimi i Planit të Integritetit është shprehje konkrete e vullnetit dhe përkushtimit për të luftuar praktikat abuzive dhe korruptive nga ana e institucionit tonë, si edhe e qëndrimit pro-aktiv për të mbështetur përpjekjet dhe reformat antikorrupsion.

Plani i Integritetit të Sekretariatit Kombëtar EITI Shqipëri është miratuar me Urdhrin e Brendshëm nr.128/1 prot, datë 12.07.2024 të Drejtorit të Përgjithshëm.

Ky Plan Integriteti përfshin risqet e integritetit sipas fushave funksionale të Sekretariatit Albeiti dhe aktivitetet konkrete për adresimin e tyre. Qëllimi tij është përmirësimi i politikave, rregullave, praktikave të parandalimit të korrupsionit, si dhe forcimi i rezistencës institucionale ndaj shkeljeve të integritetit. Plani i Integritetit për institucionin tonë do të ndikojë pozitivisht në cilësinë e punës së institucionit, si dhe në rritjen e besimit të publikut dhe të partnerëve vendas dhe të huaj me të cilët Sekretariati bashkëpunon.

Jemi të ndërgjegjshëm se dhënia e shembullit të mirë dhe menaxhimi i integritetit duke ndjekur para së gjithash standarde të larta profesionale dhe etikën në punë, do të sigurojnë një zbatim efektiv të Planit të Integritetit nga të gjitha nivelet e institucionit, duke kontribuar në këtë mënyrë në luftën kundër korrupsionit.

Qëllimi i Planit të Integritetit në institucionin tonë është: i) vlerësimi i risqeve të integritetit të cilat kompromentojnë aftësinë e Sekretariatit Kombëtar EITI Shqipëri për të kryer funksionin e shërbimit publik në mënyrë të paanshme dhe të përgjegjshme dhe i faktorëve që mund të mbështesin apo rrisin risqet e vlerësuara, si dhe ii) formulimi i masave të përshtatshme për adresimin e tyre.

1. Monitorimi i Planit të Integritetit për vitin 2024

Pas vlerësimit të riskut të integritetit në Sekretariatin Albeiti, u miratua Plani i Integritetit, i cili është konceptuar i shtrirë në një periudhë 2-vjeçare, konkretisht vitet 2024 – 2025.

Nëpërmjet këtij Plani Integriteti, Sekretariati ka vendosur tre objektiva për t'u realizuar gjatë periudhës 2024 – 2025, nëpërmjet të cilëve synohet që të minimizohen dhe adresohen risqet e integritetit të konstatuara. Objektivi përfundimtar i këtij plani është ndërtimi i një sistemi të brendshëm efektiv dhe forcimi i kulturës së integritetit institucional.

Objektivat strategjikë të përcaktuar në Planin e Integritetit, janë:

- **Objektivi 1**: Përmirësim i menaxhimit të burimeve njerëzore, kualifikim i shtuar dhe kapacitete të trajnuara
- **Objektivi 2**: Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator si instrument i luftës kundër korrupsionit
- **Objektivi 3**: Transparencë e shtuar dhe e plotë institucionale, partneritet me grupet e interesit dhe publikun

Këto objektiva strategjikë bazohen dhe përputhen me parimet e menaxhimit të riskut të integritetit të MVRI, me vizionin e SNKK, si edhe me paketën e legjislacionit në fushën e anti-korrupsionit, parandalimit të konfliktit të interesit dhe transparencës në sektorin publik. Këto objektiva do të udhëheqin punën e institucionit përgjatë periudhës së parashikuar, duke angazhuar në mënyrë të drejtpërdrejtë të gjitha strukturat dhe nëpunësit përgjegjës.

Ky raport monitorimi është i pari dokument i hartuar që prej miratimit të Planit të Integritetit dhe jep të dhëna për objektivat dhe masat institucionalë të parashikuar në Planin e Integritetit të Sekretariatit Albeiti.

1.1 Qasja vlerësuese

Raporti i monitorimit të zbatimit të planit të integritetit të Sekkretariatit Kombëtar EITI Shqipëri përmban një analizë të përgjithshme të zbatueshmërisë dhe progresit gjatë vitit 2024 për aktivitetet dhe masat e miratuara për shmangien e riskut të integritetit në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore, forcimit të kuadrit të brendshëm rregullator dhe administrativ, si dhe garantimit të transparencës te publiku.

1.2 Metodologjia e vlerësimit

Ky raport është hartuar në mbështetje të informacionit dhe ecurisë së deritanishëm në lidhje me objektivat, aktivitetet dhe masat e parashikuara për zbatim gjatë vitit 2024, në Planin e Integritetit për Sekretariatin Albeiti.

1.3 Mbledhja e të dhënave

Të dhënat e këtij raporti janë grumbulluar nga Koordinatori i Integritetit të Sekretariatit Kombëtar EITI Shqipëri, në përmbushje të rolit të tij, si struktura e posaçme përgjegjëse për

mbledhjen, analizën e informacionit, si dhe hartimin e raportit të monitorimit. Koordinatori i Integritetit i raporton titullarit të institucionit mbi ecurinë e zbatimit të Planit të Integritetit. Titullari i institucionit merr masa për garantimin e zbatimit të Planit të Integritetit dhe adresimin e problematikave të ngjashme.

Këto të dhëna janë raportuar nga përfaqësuesit e njësive kontribuese në këtë raport, të cilat janë:

- Sektori për Zbatimin e Iniciativës EITI në Shqipëri
- Sektori i Shërbimeve Mbështetëse

1.4 Monitorimi i zbatimit të planit të veprimit

Në përfundim të monitorimit për zbatimin e Planit të Integritetit të Sekretariatit Kombëtar EITI Shqipëri, periudha Janar – Dhjetor 2024, rezulton:

Në total për vitin 2024 janë parashikuar 4 aktivitete, nga të cilat:

- Realizuar: 3 aktivitete (75%)
- Në proces realizimi: 1 aktivitet (25%)
- Pa realizuar: -

Gjetjet e monitorimit sipas objektivave strategjikë paraqiten, si në vijim:

Objektivi 1: Përmirësim i menaxhimit të burimeve njerëzore, kualifikim i shtuar dhe kapacitete të trajnuara

Ky objektiv synon rritjen e efektivitetit në menaxhimin e burimeve njerëzore dhe përfshin 2 (dy) aktivitete specifikë të planifikuar për t'u zbatuar gjatë periudhës raportuese. Njësitë raportuese për këtë objektiv janë Sektori për Zbatimin e Iniciativës EITI në Shqipëri dhe Sektori i Shërbimeve Mbështetëse.

Nga monitorimi për këtë objektiv strategjik rezulton:

- Realizuar: 2 aktivitete (100%)
  - *Evidentimi i vazhdueshëm i nevojave për trajnim i stafit të ri apo ekzistues;*
  - *Ndjekja e trajnimeve sipas nevojave të stafit dhe fushave të përgjegjësisë (kryesisht prokurimet publike dhe sektori i industrive nxjerrëse).*

- Në proces realizimi: -
- Pa realizuar: -

Gjatë vitit 2024, nga ana e stafit të institucionit janë evidentuar në vijimësi nevojat për trajnim sipas fushës së veprimtarisë për secilin punonjës. Këto kërkesa për trajnim janë paraqitur pranë ministrisë linjës dhe i referohen kryesisht temave të trajnimit të publikuara

nga ASPA. Sa i takon trajnime të zhvilluara, gjatë viti raportues janë trajnuar 5 punonjës organikë të insitucionit (pjesa tjetër e pozicioneve kanë qënë vakant), të cilët në total kanë ndjekur 15 trajnime sipas detyrave të punës dhe profileve përkatës. Trajnimet janë ndjekur në mënyrë të vazhdueshme dhe kanë ndihmuar në rritjen e aftësive profesionale të stafit të institucionit duke forcuar kapacitetet në burime njerëzore për institucionin.

Objektivi 2: Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator si instrument i luftës kundër korrupsionit

Përmes këtij objektivi synohet të forcohen mekanizmat e brendshëm që rregullojnë proceset e punës në institucion, si dhe mekanizmat e kontrollit. Nga monitorimi rezultoi se, për këtë objektiv strategjik nuk ka asnjë aktivitet të parashikuar për të përfunduar gjatë periudhës raportuese.

Objektivi 3: Transparencë e shtuar dhe e plotë institucionale, partneritet me grupet e Interesit dhe publikun

Ky objektiv synon rritjen e transparencës së punës dhe veprimtarisë së insititucionit për publikun dhe bashkëpunëtorët vendas dhe të huaj. Për realizimin e këtij objektivi, në PI janë parashikuar 2 aktivitete për realizim gjatë vitit 2024. Njësitë raportuese për këtë objektiv janë Sektori për Zbatimin e Iniciativës EITI në Shqipëri dhe Sektori i Shërbimeve Mbështetëse.

Nga monitorimi për këtë objektiv strategjik rezulton:

- Realizuar: 2 aktivitete (100%)
  - *Përditësimi i vazhdueshëm i informacionit në faqen web të Sekretariatit Albeiti; Përputhja e informacioneve dhe materialeve në të dy ndërfaqet e web-it (gjuha shqip dhe anglisht);*
  - *Publikimi në kohë në web-in e institucionit i materialeve raportuese dhe llogaridhënëse ndaj publikut, konkretisht: Detajimi dhe realizimi buxhetor; Regjistrat e parashikimit të prokurimeve publike; Regjistrat e realizimit të prokurimeve publike; Baza ligjore e institucionit (e përditësuar).*

- Në proces realizimi: -
- Pa realizuar: -

Sekretariati Kombëtar EITI Shqipëri administron faqen zyrtare në internet me adresë https://www.albeiti.org/site/. Gjatë vitit raportues, stafi i institucionit, sipas detyrave që realizon secili, është angazhuar maksimalisht për përgatitjen e materialeve informuese dhe llogaridhënëse dhe publikimin e tyre në faqen web të institucionit. Nga monitorimi rezulton se, disa nga materialet më kryesore të publikuara gjatë periudhës raportuese janë:

- Raporti EITI për vitet 2019, 2020 dhe 2021 (*Rubrika Raportimi EITI*)

- Raporti EITI për vitin 2022 (*Rubrika Raportimi EITI*)
- Përditësuar lista me anëtarët e Grupit Ndërinstitucional të punës (*Rubrika MSG*)
- VKM nr.756, datë 20.12.2023 (*Rubrika Legjislacioni*)
- Plani i Integritetit 2024-2025 (*Rubrika PT*)
- Detajimi buxhetor për vitin 2024 (*Rubrika PT*)
- Raportet e monitorimit për vitin 2023 dhe 2024 (*Rubrika PT*)
- Regjistri i parashikimit të prokurimeve publike 2024 (*Rubrika PT*)
- Regjistri i realizimit të prokurimeve publike 2024 (*Rubrika PT*)
- Aktivitete, takime dhe vizita pune gjatë vitit (*Rubrika Lajme*)

2. Konkluzione dhe rekomandime

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për vitin 2024, të gjetjeve që ky dokument na ofron, të dhënave analitike të raportuara nga sektorët përkatës dhe të analizës së kryer, rezulton se:

Sekretariati Kombëtar EITI Shqipëri ka vijuar me zbatimin e Planit të Integritetit, duke arritur përmbushjen e aktiviteteve në një nivel mjaft të mirë. Gjatë vitit 2024, ka patur aktivitete të parashikuara për realizim në kuadër të arritjes së objektivit strategjik 1 dhe 3, të cilët janë realizuar plotësisht. Realizimi i Planit të Integritetit paraqitet në masën 100%, duke sjellë forcimin e kapacitetit të burimeve njerëzore në institucion, si dhe garantimin e transparencës dhe llogaridhënies te publiku.

Në përfundim, rekomandohet:

- Të vijojë angazhimi maksimal nga ana e stafit të institucionit për zbatimin e Planit të Integrimit dhe raportimin periodik të tij.